

SHKENCA NATYRORE (FIZIKE, BIOLOGJI, KIMI, GJEOGRAFI) DHE DIDAKTIKA
E TYRE

BIOLOGJI

Pyetja 1.

Indet përçues te bimët emërtohen:

- A) Sklerenkimë dhe ksilemë
- B) Kolenkimë dhe ksilemë
- C) Floemë dhe ksilemë
- D) Sklerenkimë dhe kolenkimë

Pyetja 2.

Procesi në të cilin energjia e magazinuar te karbohidratet shndërrohet në energji të përdorur nga bimët quhet:

- A) Fotosintezë
- B) Frymëmarrje
- C) Osmozë
- D) Difuzion

Pyetja 3.

Mungesa e vitaminës D shkakton sëmundjen e:

- A) Takikardisë
- B) Rakitizmit
- C) Hemofilisë
- D) Skoliozës

Pyetja 4.

Cila prej alternativave të mëposhtme është e saktë?

- A) Kotiledonet janë kërcell i embrionit.
- B) Kotiledonet janë rrënjët e embrionit.
- C) Kotiledonet janë gjethet e embrionit.
- D) Kotiledonet janë lulet e embrionit.

Pyetja 5.

Cila është përgjigja e saktë?

- A) Zhardhokët e patates janë gjethet e vërteta
- B) Zhardhokët e patates janë kërcel nentokësorë.
- C) Zhardhokët e patates janë rrënjë mbitokësore.
- D) Zhardhokët e patates janë gjethet ujore mbitokësore.

Pyetja 6.

Cili prej reaksioneve të mëposhtme është i frymëmarrjes qelizore?

- A) $C_6H_{12}O_6 + O_2 = 6 CO_2 + 6 H_2O + 1358 KJ$
- B) $C_6H_{12}O_6 + O_2 = 6 CO_2 + 6 H_2O + 1458 KJ$
- C) $C_6H_{12}O_6 + O_2 = 6 CO_2 + 6 H_2O + 1558 KJ$
- D) $C_6H_{12}O_6 + O_2 = 6 CO_2 + 6 H_2O + 1658 KJ$

Pyetja 7.

Gjitarët ndryshojnë nga shpendët sepse:

- A) Kanë temperaturë të panndryshueshme.
- B) Ushqejnë të vegjëlit me qumësht.
- C) Jetojnë kudo.
- D) Kanë prejardhjen prej zvarranikëve.

Pyetja 8.

Dukuria kalimit të ujit në avuj në gjethe quhet:

- A) Plasmolize
- B) Transpiracion
- C) Difuzion
- D) Osmozë

Pyetja 9.

Hormoni bimor që stimulon ndarjen qelizore quhet:

- A) Acidi abscisik
- B) Etilen
- C) Citokininë
- D) Giberelinë

Pyetja 10.

Nga kombinimi i 20 lloje aminoacidesh formohen:

- A) Acidet nukleike
- B) Karbohidratet
- C) Proteinat
- D) Lipidet

Pyetja 11.

Cila prej alternativave të mëposhtme është e saktë?

- A) Valvulat lejojnë kalimin e gjakut në arterie.
- B) Valvulat lejojnë kalimin e gjakut në një drejtim.
- C) Valvulat lejojnë kalimin e gjakut në vena.
- D) Valvulat lejojnë kalimin e gjakut në kapilarë.

Pyetja 12.

Cila prej alternativave të mëposhtme nuk është hormon bimor:

- A) Auksina
- B) Insulina
- C) Giberelin
- D) Etileni

Pyetja 13.

Zigota formohet nga bashkimi:

- A) Dy qelizave diploide.
- B) Gametit femërorë dhe një qelize diploide.
- C) Një qelize aploide dhe një qelize diploide.
- D) Gametit femërorë dhe gametit mashkullorë.

Pyetja 14.

Cila prej alternativave të mëposhtme është pjesë e aparatit të tretjes dhe frymëkëmbimit:

- A) Ezofag
- B) Faring
- C) Alveola
- D) Stomak

Pyetja 15.

Riprodhimi me anë të gjetheve quhet:

- A) Seksual
- B) Hermafrodit
- C) Vegjetativ
- D) Merogoni

Pyetja 16.

Gjallesat të cilat nuk kanë bërthamë quhen:

- A) Prokariote
- B) Klone
- C) Hermafrodite
- D) Eukariote

Pyetja 17.

Gjallesat që e sintetizojnë vetë ushqimin quhen:

- A) Heterotrofe
- B) Autotrofe
- C) Dekompozuese
- D) Konsumatore

Pyetja 18.

Cila është alternativa e saktë? Janë pjesët e frutit:

- A) Epikardi, Miokardi, Endokardi
- B) Mukoza, Submukoza, Seroza
- C) Epikarpi, Mezokarpi, Endokarpi
- D) Androceu, Gjinoceu, Kurora

Pyetja 19.

Nuk është funksion i aparatit të ekskretimit:

- A) Largimi i CO₂
- B) Largimi i uresë
- C) Ruajtja e homeostazës
- D) Tretja e ushqimeve

Pyetja 20.

Cila është përgjigja e gabuar?

- A) Monerët janë prokariotë.
- B) Monerët janë njëqelizorë.
- C) Monerët janë ekuariotë.
- D) Bakteret bëjnë pjesë të monerët.

Pyetja 21.

Nëse një qelizë ka $2n=24$ kromozome sa kromozome ka një gamet?

- A) 10
- B) 12
- C) 14
- D) 16

Pyetja 22.

Simbioza midis një kërpudhe dhe një alge emërtohet:

- A) Mikorizë
- B) Liken
- C) Mastigofor
- D) Ciliat .

Pyetja 23.

Zona e dushkut bën pjesë në:

- A) Zonimin horizontal
- B) Zonimin vertikal
- C) Kullotat alpine
- D) Zonën e shkurreve

Pyetja 24.

Robert Huku në vitin 1665 zbuloi:

- A) Mikroskopin
- B) Algat
- C) Qelizën
- D) Bërthamën

Pyetja 25.

Gjeni përgjigjen e saktë.

- A) Homo sapiens është njeriu i sotëm.
- B) Homo sapiens është homo erektum.
- C) Homo sapiens është australopiteku.
- D) Homo sapiens është homo habilis.

Pyetja 26.

Cila është përgjigja e saktë?

- A) Etologjia është shkenca që studion qelizën.
- B) Etologjia është shkenca që studion sjelljet e gjallesave.
- C) Etologjia është shkenca që studion bimët.
- D) Etologjia është shkenca që studion kafshët.

Pyetja 27.

Cili është ndryshimi midis qelizës bimore dhe shtazore:

- A) Prania e bërthamës
- B) Prania e kloroplastit
- C) Prania e citoplazmës
- D) Prania e ribozomeve

Pyetja 28.

Nëse një qelizë ka $2n=46$ kromozome dhe i nënshtrohet mitozës, cili është numri i kromozomeve në qelizat bija?

- A) 23
- B) 36
- C) 43
- D) 46

Pyetja 29.

Rruazat e kuqe janë elemente të:

- A) Limfës
- B) Gjakut

- C) Muskujve
- D) Lëkurës

Pyetja 30.

Organelat që luajnë rol në sintezën e proteinave janë:

- A) Ribozomet
- B) Lizozomet
- C) Mitokondritë
- D) Vakuolat

Pyetja 31.

Kloroplastet janë organela në të cilat realizohet procesi i:

- A) Frymëmarrjes
- B) Fotosintezës
- C) Ekskretimit
- D) Tretjes

Pyetja 32.

Cili përcaktim është i vërtetë?

- A) Kërpudhat janë eukariotë heterotrofë.
- B) Kërpudhat janë prokariotë autotrofë.
- C) Kërpudhat janë shumëqelizorë prokaritë.
- D) Kërpudhat janë njëqelizorë eukariotëe.

Pyetja 33.

Cila është alternativa e gabuar:

- A) Amfibët jetojnë në ujë dhe në tokë.
- B) Lëkura e tyre është e njomë.
- C) Larvat realizojnë frymëkëmbimin me mushkëri.
- D) Zemra është e ndarë në tri dhoma.

Pyetja 34.

Qarkullimi i madh i gjakut është kalimi gjakut nga:

- A) Ventrikuli i majtë në të gjithë organizmin.
- B) Ventrikuli i majtë në mushkëri.
- C) Ventrikuli i djathtë në të gjithë organizmin.
- D) Ventrikuli i djathtë në mushkëri.

Pyetja 35.

Cila është alternativa e saktë?

- A) Gjenerali është pjesë e lipideve që përmbajnë informacionin për një varg polipeptidik.
- B) Gjenerali është pjesë e ADN që përmbajnë informacionin për një varg polipeptidik.
- C) Gjenerali është pjesë e adeninës që përmbajnë informacionin për një varg polipeptidik.
- D) Gjenerali është pjesë e guaninës që përmbajnë informacionin për një varg polipeptidik.

Pyetja 36.

Cili është alternativa e gabuar?

- A) Në sistemin taksonomik përdoret një hierarki taksash.
- B) Taksa bazë është specia.
- C) Taksa tjetër është celumi.
- D) Taksa tjetër është mbretëria.

Pyetja 37.

Bashkësia e qelizave me preardhje, ndërtim dhe funksion të njëjtë quhet:

- A) Ind
- B) Organ
- C) Gjendër
- D) Organizëm

Pyetja 38.

Hemoglobina është përbërës i rruazave të kuqe dhe është:

- A) Lipid
- B) Proteinë
- C) Vitaminë
- D) Acid nukleik

Pyetja 39.

Breshkat bëjnë pjesë të:

- A) Peshqit
- B) Amfibët
- C) Zvarranikët
- D) Gjitarët

Pyetja 40.

Cila është alternativa e saktë: *Simetria trupore është?*

- A) Vendosja e pjesëve të trupit në raport me boshtin qendror të rrotullimit të trupit.
- B) Vendosja e pjesëve të trupit në raport me boshtin qendror të rrotullimit të gjymtyrëve.
- C) Vendosja e pjesëve të trupit në raport me boshtin qendror të rrotullimit të kokës.
- D) Vendosja e pjesëve të trupit në raport me boshtin qendror të rrotullimit të zemrës.

Pyetja 41.

Trupi i kandrrave përbëhet nga 3 pjesë:

- A) Koka, gjoksi, zemra.
- B) Koka, gjoksi, antena.
- C) Koka, gjoksi, barku.
- D) Koka, gjoksi, bishti.

Pyetja 42.

Nëse një qelizë ka $2n=36$ kromozome dhe i nënshtrohet procesit të mejozës cili është numri i kromozomeve në fund të mejozës?

- A) 12
- B) 18
- C) 23
- D) 28

Pyetja 43.

Tërësia e kromozomeve të fotografuara të një qelize diploide quhet:

- A) Kariotip
- B) Centromer
- C) ADN
- D) Gjen

Pyetja 44.

Organelat në të cilat kryhet procesi i frymëmarrjes qelizore janë:

- A) Vakuolat
- B) Mitokondritë
- C) Kloroplastet
- D) Bërthama

Pyetja 45.

Kafshët që kanë të çara në faring, tubin nervor shpinor dhe kordë bëjnë pjesë të?

- A) Gjitarët
- B) Kandrrat
- C) Butakët
- D) Kordatët

Pyetja 46.

Cila prej alternativave është e saktë? *Zemra te njeriu është e përbërë nga:*

- A) 4 dhoma - 2 atriume dhe 2 ventrikuj

- B) 3 dhoma - 2 atriume dhe 1 ventrikul
- C) 3 dhoma - 1 atrium dhe 2 ventrikuj
- D) 4 dhoma - 3 atriume dhe 1 ventrikul

Pyetja 47.

Nuk është funksion i lëkurës:

- A) Funksioni mbrojtës
- B) Funksioni termorregullues
- C) Funksioni receptor
- D) Funksioni tretës

Pyetja 48.

Gjatë ciklit të zhvillimit, shiriti i derrit kalon në dy bujtësa:

- A) Derri dhe lopa
- B) Derri dhe miu
- C) Derri dhe njeriu
- D) Derri dhe qeni

Pyetja 49.

Metameria ndryshon nga simetria pasi kemi të bëjmë me kafshë:

- A) Me trup të segmentuar.
- B) Me trup me cilie.
- C) Me trup të butë.
- D) Me trup me luspa.

Pyetja 50.

Mbeturinat e pjesëve të ngurta të trupit si kocka, dhëmbë dhe brirë quhen:

- A) Rudimente
- B) Fosile
- C) Atavizma
- D) Drift

Pyetja 51.

Elementët që në qelizë gjenden në sasi të mëdha quhen:

- E) Ekuivalente
- F) Mikroelementë
- G) Makroelementë
- H) Ultramikroelementë

Pyetja 52.

ADN-ja luan rol në:

- E) Sintezën e proteinave në ribozome
- F) Zhvillimin e reaksioneve biologjike
- G) Mbartjen e informacionit gjenetikë
- H) Tretjen e proteinave në qelizë

Pyetja 53.

Ngjyra e karrotës i dedikohet pranisë së:

- E) Kromoplasteve
- F) Kloroplasteve
- G) Leukoplasteve
- H) Vakuolave

Pyetja 54.

Cila prej alternativave të mëposhtme është e saktë? *Nuk është përfaqësues i butakëve:*

- E) Kërmilli
- F) Midhja
- G) Oktapodi
- H) Hidra

Pyetja 55.

Periudha e shumëzimit të shpendëve quhet:

- E) Shtegtim
- F) Fluturim
- G) Folëzim
- H) Migrim

Pyetja 56

Nuk është gjitar:

- E) Lakuriqi i natës
- F) Ketri
- G) Balena
- H) Pulëbardha

Pyetja 57.

Pjesa e embrionit që ka për funksion grumbullimin e lëndëve rezervë quhet:

- E) Kotiledon
- F) Rrënjë
- G) Kërçell

H) Sythë

Pyetja 58.

Cila është alternativa e saktë? *Transporti i lëndëve organike në bimë bëhet nëpërmjet:*

- E) Floemë
- F) Ksilemë
- G) Trake
- H) Trakeide

Pyetja 59.

Androceu është tërësia e organeve mashkullore që te lulja quhen:

- E) Vezore
- F) Kreza
- G) Thekët
- H) Shtyllëza

Pyetja 60.

Lulet hermafrodite ndryshojnë nga ato njëseksore pasi kanë:

- E) Tre organe seksuale
- F) Dy organe seksuale
- G) Një organ seksual
- H) Asnjë organ seksual

Pyetja 61.

Nuk është riprodhim vegjetativ riprodhimi me anë të:

- E) Copëzimit
- F) Bulëzimit
- G) Kalemave
- H) Gametëve

Pyetja 62.

Gjallesat që nuk kanë membranë bërthamore quhen:

- E) Prokariot
- F) Eukariot
- G) Tal
- H) Likene

Pyetja 63.

Djersa pengon në zhvillimin e:

- E) Thonjve
- F) Baktereve
- G) Vitaminës D
- H) Proteinave

Pyetja 64.

Është funksion i vitaminës D:

- E) Nxit përthithjen e Na në zorrë
- F) Nxit përthithjen e Cu në zorrë
- G) Nxit përthithjen e Mg në zorrë
- H) Nxit përthithjen e Ca në zorrë

Pyetja 65.

Sheqernat shërbejnë si burim:

- E) Energjie
- F) Enzimatik
- G) Osmotik
- H) Qarkullues

Pyetja 66.

Aminoacidet që merren të gatshme nga ushqimet quhen:

- E) Të lëkurës
- F) Të aparatit tretës
- G) Të muskujve
- H) Esenciale

Pyetja 67.

Nuk është pjesë e aparatit tretës:

- E) Goja
- F) Mëlçia
- G) Laringu
- H) Stomaku

Pyetja 68.

Rruazat e bardha kanë funksion:

- E) Transportues
- F) Koagulues
- G) Ushqyes
- H) Mbrojtës

Pyetja 69.

Valvula e anës së djathtë të zemrës ndryshon nga ajo e anës së majtë pasi përbëhet nga:

- E) 1 kllapëz
- F) 2 kllapëza
- G) 3 kllapëza
- H) 4 kllapëza

Pyetja 70.

Cila është përgjigja e saktë ? *Tkurrja e atriumeve dhe ventrikujve quhet:*

- E) Sistolë
- F) Diastolë
- G) Takikardi
- H) Bradikardi

Pyetja 71.

Imuniteti qelizor dhe humoral ndryshon pasi në rastin e parë i detyrohet:

- E) Qelizave B
- F) Qelizave C
- G) Qelizave R
- H) Qelizave T

Pyetja 72.

Sistemi nervor përbëhet nga:

- E) SNQ dhe PK
- F) SNP dhe nerva
- G) SNQ dhe SNP
- H) SNQ dhe truri

Pyetja 73.

Lëkura e amfibëve është:

- E) E lagur
- F) E thatë
- G) Me luspa
- H) Me qime

Pyetja 74.

Cila është përgjigja e saktë ? *Paraziti që shkakton malarien është:*

- E) Monerë

- F) Protistë
- G) Kërpudhë
- H) Mikorizë

Pyetja 75.

Askaridi që paraziton te njeriu bën pjesë te:

- E) Krimbat e shtypur
- F) Krimbat e rrumbulakët
- G) Krimbat unazorë
- H) Butakët

FIZIKË

Pyetja 1.

Milibar është njësia për matjen e:

- D) Shtypjes
- J) Gjatësisë
- K) Viskozitetit
- L) Shpejtësisë

Pyetja 2.

Cila prej madhësive të mëposhtme është madhësi skalare:

- A) Shpejtësia
- B) Forca
- C) Nxitimi
- D) Temperatura

Pyetja 3.

Cila nga madhësitë e mëposhtme është madhësi vektoriale:

- A) Koha
- B) Temperatura
- C) Fuqia
- D) Forca

Pyetja 4.

Forca që i komunikon trupit me masë 1 kg nxitimin 1m/s^2 është:

- A) 100N
- B) 1N
- C) 10N
- D) 1J

Pyetja 5.

Energjia në sistemin SI matet me:

- A) Kelvin
- B) Njuton
- C) Xhaul
- D) Gradë celsius

Pyetja 6.

Cili është kampioni i dytë për njësinë e matjes së masës:

- A) Atomi i karbonit -12
- B) Atomi i uraniumit
- C) Një grimcë pluhuri
- D) Elektroni

Pyetja 7.

Cili nga pohimet është i saktë:

- A) Njësia matëse e peshës së trupit është kg.
- B) Nëse trupi është i vogël, pesha e tij matet me gr.
- C) Pesha e trupit është gjithmonë proporcionale me masën.
- D) Pesha e trupit është një karakteristikë e tij.

Pyetja 8.

Cila nga vlerat e mëposhtme shpreh atë të nxitimit të rënies së lirë afër Tokës:

- A) 10 m/s^2
- B) 9 m/s^2
- C) 9.8 m/s^2
- D) 10.2 m/s^2

Pyetja 9.

Zhvendosja është madhësi vektoriale që karakterizohet:

- A) Nga një drejtim
- B) Nga një kah
- C) Nga një modul
- D) Nga të treja së bashku

Pyetja 10.

Shpejtësimatësi i automobilave mat:

- A) Shpejtësinë skalare
- B) Shpejtësinë vektoriale
- C) Shpejtësinë vektoriale të çastit
- D) Të trija së bashku

Pyetja 11.

Cili nga pohimet është i saktë:

- A) Masa është dimension i një trupi.
- B) Masa është një karakteristikë e brendshme e një trupi.
- C) Masa tregon peshën e trupit.
- D) Masa tregon densitetin e trupit.

Pyetja 12.

Ligji i tretë i Njutonit tregon se *Forcat kanë*:

- A) Të njëjtën vlerë, drejtime të ndryshme.
- B) Të njëjtën vlerë, drejtime dhe kahe të kundërta.
- C) Të njëjtën vlerë dhe kahe të kundërta.
- D) Vlera të ndryshme, drejtime të njëjta.

Pyetja 13.

Cila nga forcat ka natyrë gravitacionale:

- A) P – pesha e një trupi
- B) T – tensioni i fillit
- C) N – forca normale
- D) f – forca e fërkimit

Pyetja 14.

Ligjet e Njutonit janë:

- A) Tre
- B) Dy
- C) Një
- D) Katër

Pyetja 15.

Cili nga pohimet për energjinë potenciale të trupit është i saktë:

- A) Varet nga mjedisi ku ndodhet.
- B) Nuk varet nga masa e trupit.
- C) Varet nga sistemi i referimit i zgjedhur.
- D) Varet nga temperatura e trupit.

Pyetja 16.

Energjia mesatare kinetike e molekulave të një lënde shprehet me:

- A) Vat
- B) Xhaul
- C) Njuton
- D) Paskal

Pyetja 17.

Sasia e lëvizjes së një trupi ka si njësi matjeje:

- A) J
- B) $\text{kg} \cdot \text{m}$
- C) kg/s
- D) m/s

Pyetja 18.

Gjatë rënies së topit elastik në dysheme të fortë, goditja në dysheme do të konsiderohet:

- A) Plotësisht elastike
- B) Pjesërisht jo elastike
- C) Jo elastike

D) Elastike

Pyetja 19.

Gjatë një goditjeje elastike të dy trupave, ato kanë vetinë të ruajnë:

- A) Energjinë kinetike
- B) Energjinë potenciale
- C) Energjinë mekanike
- D) Shpejtësinë fillestare

Pyetja 20.

Cila nga madhësitë e mëposhtme nuk i përket lëvizjes rrotulluese të trupit të ngurtë:

- A) Zhvendosja këndore
- B) Shpejtësia këndore
- C) Nxitimi
- D) Pozicioni këndor

Pyetja 21.

Njësia e nxitimit këndor gjatë rrotullimit të trupit është:

- A) rad/s
- B) rad/s^2
- C) $\text{rad} \cdot \text{s}$
- D) $\text{rad} \cdot \text{s}^2$

Pyetja 22.

Simboli “c” në formulën $E=mc^2$ paraqet:

- A) Nxitimin gravitacional
- B) Nxehtësinë specifike
- C) Shpejtësinë e dritës
- D) Shpejtësinë e tingullit

Pyetja 23.

Cili nga trupat e ngurtë është më elastiku:

- A) Gozhda prej hekuri
- B) Tavolina
- C) Luga
- D) Dorezat e gomës

Pyetja 24.

Në cilin rast trupi është në ekuilibër statik:

- A) Disku i hokejit kur rrëshket mbi akull
- B) Fletët rrotulluese të ventilatorit
- C) Libri mbi tavolinë
- D) Rrota e biçikletës në lëvizje

Pyetja 25.

Cili nga rastet nuk paraqet shembull të lëvizjes oshiluese:

- A) Barkat që lëkunden
- B) Vajza në lisharës
- C) Makina në ecje të përshpejtuar
- D) Valët e radios

Pyetja 26.

Vlera e forcës së tërheqjes gravitacionale nuk varet nga:

- A) Konstantja e gravitacionit
- B) Distanca që i ndan dy trupat
- C) Masat e dy trupave
- D) Nga natyra e vendit ku ndodhen

Pyetja 27.

Forca ngritëse e krahut të aeroplanit në fluturim shpjegohet më mirë me anë të ligjit:

- A) Arkimedit
- B) Bernulit
- C) Faradeit

D) Toriçelit

Pyetja 28.

Cila nga lëndët e mëposhtme nuk është fluid:

- A) Sera
- B) Uji
- C) Avulli
- D) Hekuri

Pyetja 29.

Densiteti i një fluidi përcaktohet nga:

- A) Raporti m/v
- B) Prodhimi mv
- C) Prodhimi ma
- D) Raporti m/a

Pyetja 30.

Parimi i Arkimedit tregon:

- A) Ndryshimin e presionit të aplikuar në fluid.
- B) Shtypjen e drejtuar lart në fluid.
- C) Vlerën e forcës së ushtruar nga lart.
- D) Presionin e ushtruar nga të gjitha anët në fluid.

Pyetja 31.

Parimi i Paskalit pohon se *Shtypja e ushtruar në një lëng të mbyllur:*

- A) Është në përpjestim të drejtë me densitetin e tij.
- B) Është në përpjestim të drejtë me thellësinë e tij.
- C) Është në përpjestim të drejtë me volumin e tij.
- D) Përhapet pa humbje në të gjitha drejtimet.

Pyetja 32.

Kur nxehtësia Q transferohet nga mjedisi në sistem ajo është:

- A) Negative
- B) Pozitive
- C) Zero
- D) Asnjëra prej tyre

Pyetja 33.

Kur peshku e rrit dendësinë e vet ai zhytet më thellë, nëse bëhet më i lehtë i afrohet sipërfaqes së ujit. Ai vepron kështu për shkak të:

- A) Parimit të Arkimedit
- B) Parimit të Paskalit
- C) Ligjit të parë të Njutonit
- D) Ligjit të Lencit

Pyetja 34.

Nxehtësia konsiderohet si formë e:

- A) Fuqisë
- B) Dritës
- C) Rrezatimit
- D) Energjisë

Pyetja 35.

Si njësi për matjen e fuqisë elektrike shërben:

- A) 1 kw
- B) 1 w
- C) 1 kwh
- D) 1J

Pyetja 36.

Trupi i ngarkuar pozitivisht është ai që ka humbur:

- A) Protone
- B) Jone
- C) Fotone
- D) Elektrone

Pyetja 37.

Me kulon C matet:

- A) Rezistenca elektrike
- B) Intensiteti i rrymës elektrike
- C) Diferenca e potencialeve
- D) Ngarkesa elektrike

Pyetja 38.

Cila nga njësitë shpreh kapacitetin e kondesatorit:

- A) C/A
- B) A/V
- C) V
- D) F

Pyetja 39.

Cila nga materialet është veçues:

- A) Trupi i njeriut
- B) Qelqi
- C) Metalet
- D) Valvola e ujit

Pyetja 40.

Në elektrostatikë ruajtja e energjisë potenciale elektrostатike kryhet me anën e:

- A) Gjysmëpërcjellësve
- B) Superpërcjellësve
- C) Kondesatorëve
- D) Asnjërit prej tyre

Pyetja 41.

Formula që lidh energjinë elektrike me tensionin dhe rrymën është:

- A) $E=U/I$
- B) $E=I/U$
- C) $E=IU$
- D) $E=I^2U$

Pyetja 42.

Raporti i diferencës së potencialeve në skajet e një përcjellësi me rrymën që rrjedh në të quhet:

- A) Intensitet
- B) Përcjellshmëri
- C) Rezistencë
- D) Potencial elektrik

Pyetja 43.

Energjia elektrike që ruhet në kondesator vjen nga:

- A) Puna e kryer për ngarkimin e tij
- B) Puna e kryer nga forcat e tërheqjes së gjithësishtme
- C) Puna e kryer nga forcat elastike
- D) Puna e kryer nga rezistenca

Pyetja 44.

Si ndryshon moduli i intensitetit të fushës elektrike të një ngarkese pikësore, nëse largësia nga ajo rritet 4 herë:

- A) Zvogëlohet 4 herë
- B) Zvogëlohet 2 herë
- C) Zvogëlohet 16 herë
- D) Rritet 16 herë

Pyetja 45.

Nëse frekuenca e valës rritet, atëherë perioda e valës:

- A) Zvogëlohet
- B) Rritet
- C) Nuk ndryshon
- D) Nuk mund të përcaktohet

Pyetja 46.

Të gjitha valët elektromagnetike në boshllëk kanë të njëjtë:

- A) Frekuencën
- B) Gjatësinë e valës
- C) Shpejtësinë
- D) Energjinë

Pyetja 47.

Gjatësia e valës është:

- A) Gjerësia e lëkundjeve që gjenerohen.
- B) Shpejtësia me të cilën përhapet vala.
- C) Rruga e përshkuar gjatë 1 sekonde.
- D) Rruga e përshkuar gjatë kohës që kryhet një lëkundje e plotë.

Pyetja 48.

Në cilat mjedise elastike mund të lindin valët tërthore:

- A) Në mjediset e ngurtë
- B) Në mjediset e lëngët
- C) Në mjediset e gaztë
- D) Në zbrazëti

Pyetja 49.

Shpejtësia e përhapjes në kordën e tendosur varet nga:

- A) Amplituda e valës
- B) Gjatësia e valës
- C) Forca tendosëse e kordës
- D) Forma e valës

Pyetja 50.

Gjatë përhapjes së valëve në një mjedis transferohet:

- A) Vetëm energji
- B) Vetëm masë
- C) Masë dhe energji
- D) As masë dhe as energji

Pyetja 49.

Shpejtësia e përhapjes në kordën e tendosur varet nga:

- E) Amplituda e valës
- F) Gjatësia e valës
- G) Forca tendosëse e kordës
- H) Forma e valës

Pyetja 50.

Gjatë përhapjes së valëve në një mjedis transferohet:

- E) Vetëm energji
- F) Vetëm masë
- G) Masë dhe energji
- H) As masë dhe as energji

Pyetja 51.

Nëse gjatësia e përcjellësit përgjysmohet, rezistenca e tij do të:

- A) Përgjysmohet
- B) Dyfishohet
- C) Zvogëlohet 4 herë
- D) Katërfishohet

Pyetja 52.

Rezistenca e një përcjellësi metalik është në përpjesëtim të zhdrejtë me:

- A) Forcën elastike
- B) Gjatësinë
- C) Seksionin tërthor
- D) Temperaturën

Pyetja 53.

Rezistenca elektrike e një përcjellësi metalik varet:

- A) Vetëm nga gjatësia dhe seksioni tërthor i përcjellësit
- B) Nga gjatësia, lloji i lëndës, seksioni tërthor
- C) Nga gjatësia, lloji i lëndës, temperatura e përcjellësit
- D) Nga të gjithë faktorët e mësipërm

Pyetja 54.

Njësia e induksionit magnetik B është:

- A) Amper
- B) Kulon
- C) Njuton
- D) Tesla

Pyetja 55.

Burimin e vijave në një magnet, me marrëveshje e quajmë:

- A) Dipol magnetik
- B) Poli Nord
- C) Poli Sud
- D) Monopol

Pyetja 56.

Një thjerrë përmbledhëse formon shëmbëllim:

- A) Real, virtual, i përmbysur
- B) Virtual, i drejtë, i zvogëluar
- C) Virtual, i drejtë, i zmadhuar
- D) Virtual, i përmbysur, i zmadhuar

Pyetja 57.

Cili nga relacionet paraqet lidhjen e largësisë vatrore f me rrezen e kurbaturës r të pasqyrës:

- A) $f=2r$
- B) $f=r/2$
- C) $f=r$
- D) Asnjëra prej tyre

Pyetja 58.

Drita shfaq natyrën korpuskulare në dukurinë e:

- A) Interferencës
- B) Difraksionit
- C) Fotoefektit
- D) Polarizimit

Pyetja 59.

Sa është numri i postulateve ku mbështetet teoria speciale e relativitetit:

- A) 3
- B) 2
- C) 1
- D) 4

Pyetja 60.

Shpejtësia e dritës merret:

- A) 300 m/s
- B) $3 \cdot 10^5$ m/s
- C) $3.0 \cdot 10^8$ m/s
- D) 30m/s

Pyetja 61.

Fluksi magnetik përmes një kuadri jepet nga formula:

- A) $\Phi = B \cdot S$
- B) $\Phi = B/S$
- C) $\Phi = S/B$
- D) $\Phi = B^2 \cdot S$

Pyetja 62.

Cili nga aparatet nuk përcakton drejtimin e fushës magnetike të Tokës:

- A) Magnetometri
- B) Barometri
- C) Busulla
- D) Dipmetri

Pyetja 63.

Cila nga alternativat nuk përkon për pasqyrën e mysët:

- A) Qendra e saj kalon prapa pasqyrës
- B) Rrit fushën e pamjes
- C) Shëmbëllimi i objektit i afrohet pasqyrës
- D) Shëmbëllimi zmadhohet

Pyetja 64.

Dukuria e difraksionit ndodh kur:

- A) Kur valët mbivendosen mbi njëra-tjetrën
- B) Kur valët përthyhen në mënyra të ndryshme

- C) Çarja ka përmasa të krahasueshme me gjatësinë e valës
- D) Çarja është me përmasa të afërta me gjatësinë e valës

Pyetja 65.

A mund të rritet shpejtësia e dritës, kur ajo kalon nga zbrazëtia në një mjedis të dhënë:

- A) Jo
- B) Po
- C) Varet nga frekuenca e valëve
- D) Varet nga gjatësia e valëve

Pyetja 66.

Në gjendje normale të atomit të hidrogjenit, elektroni i tij:

- A) Nuk është i ngacmuar
- B) Është i ngacmuar
- C) Kthehet në elektron të lirë
- D) Largohet në infinit

Pyetja 67.

Sipas teorisë së Borit, simboli që përcakton energjinë e gjendjes së atomit shënohet me:

- A) l
- B) n
- C) m
- D) h

Pyetja 68.

Izotope quhen bërthamat e atomeve:

- A)Me të njëjtin numër atomik
- B)Me të njëjtin numër elektronesh
- C)Me të njëjtin numër mase
- D)Me numra të ndryshem atomikë

Pyetja 69.

Njësia e përshtatshme për matjet në zonën e bërthamave është:

- A) mikro
- B) nano
- C)piko
- D)Fermi

Pyetja 70.

Trupi me nxitim 0:

- A)Mund të jetë në prehje
- B)Mund të kryejë lëvizje të ngadalësuar
- C)Mund të kryejë lëvizje të nxituar
- D)Mund të jetë në lëvizje

Pyetja 71.

Kur një foton kalon nga drita tek atomi thuhet se:

- A)Atomi e absorboi fotonin
- B)Atomi e emëtoi fotonin
- C)Atomit i zvogëlohet shpejtësia
- D)Atomit i rritet shpejtësia

Pyetja 72.

Cilën prej vetive të mëposhtme nuk e gëzojnë atomet:

- A)Atomet rrinë bashkë në mënyre sistematike
- B)Atomet lëshojne dhe thithin dritë
- C)Atomet kanë moment këndor dhe magnetik
- D)Atomet nuk janë të qëndrueshëm

Pyetja 73.

Eksperimenti i Radhërfordit për shpërndarjen e thërmijave nga atomet e lëndës tregon:

- A)Protonet janë më masive se elektronet.
- B)Në atome ka një ngarkese pozitive me përqendrim të lartë.
- C)Thërmijat janë të ngarkuara pozitivisht.
- D)Radioaktiviteti mund të realizohet artificialisht.

Pyetja 74

Nëse një elektron bie ne orbitën më të ulët, atëherë energjia e plotë e atomit do të:

- A)Zvogëlohet
- B)Rritet
- C)Mbetet e njëjtë
- D)Ndryshon

Pyetja 75.

Madhësia që nuk ndryshon gjatë rënies së lirë të trupave është:

- A)Zhvendosja
- B)Shpejtësia
- C)Vektori i shpejtësisë
- D)Nxitimi

GJEOGRAFI

Pyetja 1.

Zbatimi praktik i përfundimeve të studimeve gjeografike në shumë degë të jetës njerëzore gjen shprehjen e vet në të ashtuquajturën:

- A) Gjeografi fizike
- B) Gjeografi e aplikuar
- C) Hartografi
- D) Gjeografi

Pyetja 2.

Dukuria që ndodh më datën 22 Qershor është:

- A) Solstici dimëror
- B) Solstici veror
- C) Ekuinoksi pranveror
- D) Ekuinoksi vjeshtor

Pyetja 3.

Rrezet e Diellit bien pingul në Tropikun e Jugut më datën:

- A) 22 Qershor
- B) 22 Dhejtor
- C) 23 Shtator
- D) 21 Mars

Pyetja 4.

Shkalla e hartës quhet më e madhe kur ajo ka:

- A) Emëruesin më të vogël
- B) Numëruesin më të vogël
- C) Emëruesin më të madh
- D) Numëruesin më të madh

Pyetja 5.

Sipas studimeve sizmike, gravimetrike dhe magnetike në ndërtimin e brendshëm të Tokës dallohen:

- A) 3 shtresa
- B) 4 shtresa
- C) 5 shtresa
- D) 7 shtresa

Pyetja 6.

Lëvizjet epirogjenike kanë karakter:

- A) Rrudhosës
- B) Luhatës
- C) Shkëputës
- D) Të gjitha së bashku

Pyetja 7.

Nuk është pjesë përbërëse e vullkanit:

- A) Oxhaku
- B) Krateri
- C) Koni
- D) Llava

Pyetja 8.

Rreth 220 milion vjet më parë të gjithë kontinentet formonin një superkontinent të quajtur:

- A) Tedida
- B) Pangea
- C) Gonduana
- D) Laurazia

Pyetja 9.

Hipoqendër quhet:

- A) Vatra e vullkanit
- B) Shtresa përbërëse e Tokës
- C) Vatra e tërmetit
- D) Brezi sizmik

Pyetja 10.

Forca tërheqëse e Hënës dhe e Diellit shkakton formimin e:

- A) Valëve sizmike
- B) Mareve
- C) Valëve
- D) Valëve të erës

Pyetja 11.

Veçoritë fiziko-kimike të deteve varen nga:

- A) Lidhja që ka deti me oqeanin
- B) Gjerësia gjeografike ku ndodhet
- C) Madhësia e detit
- D) Të gjitha së bashku

Pyetja 12.

Ujërat nëntokësore karstike janë karakteristike për shkëmbinjtë:

- A) Sedimentarë
- B) Magamtikë
- C) Karbonatikë
- D) Metamorfikë

Pyetja 13.

Nuk është burim mineral:

- A) Burimi i Syrit të Kaltër
- B) Burimi i Shëngjinit
- C) Burimi i Bënjës në Përmet
- D) Burimi i Selenicës në Vlorë

Pyetja 14.

Arrijnë nivelin maksimal të sasisë së ujit në dimër lumenjtë:

- A) Me ushqim shiu të tipit musonik
- B) Me ushqim shiu të tipit mesdhetar
- C) Me ushqim shiu të tipit ekuatorial
- D) Me ushqim shiu të tipit oqeanik

Pyetja 15.

Përcaktohet si lumi me fuqinë gërryese më të madhe në vendin tonë:

- A) Lumi Drin
- B) Lumi Shkumbin
- C) Lumi Buna
- D) Lumi Valbona

Pyetja 16.

Nuk janë formë e krijuar nga veprimtaria e lumenjve:

- A) Konet aluvionale
- B) Deltat lumore
- C) Fushat aluvionale
- D) Rrëshqitjet

Pyetja 17.

Akullnajat e tipit norvegjez janë:

- A) Të tipit lagunor
- B) Të tipit të varur

- C) Të tipit piedmont
- D) Të tipit të ndërmjetëm

Pyetja 18.

Shtresa e dherave\tokave quhet:

- A) Atmosferë
- B) Hidrosferë
- C) Pedosferë
- D) Biosferë

Pyetja 19.

Nuk është liqen tektonik:

- A) Liqeni i Prespës
- B) Liqeni i Ohrit
- C) Liqeni i Shkodrës
- D) Liqenet e Lurës

Pyetja 20.

Kushtet më të favorshme për zhvillimin e botës organike ekzistojnë në:

- A) Zonën tropikale
- B) Zonën ekuatoriale
- C) Zonën e gjerësive mesatare
- D) Zonën polare

Pyetja 21.

Bimësia barishtore në vendin tonë është karakteristike për:

- A) Katin e shkurreve mesdhetare
- B) Katin e dushqeve
- C) Katin e ahishteve dhe halorëve
- D) Katin e kullotave alpine

Pyetja 22.

Faktori që luan rolin më kryesor në formimin e dherave është:

- A) Tiparet e relievit
- B) Veprimtaria e njeriut
- C) Kushtet klimatike
- D) Llojet e shkëmbinjve

Pyetja 23.

Planetët që ndodhen me afër diellit kanë:

- A) Masë të vogël dhe përmasa jo të mëdha
- B) Përmasa dhe masa të mëdha
- C) Masa të mëdha dhe dendësi të vogël
- D) Masa të vogla dhe dendësi të vogël

Pyetja 24.

Rrymat oqeanike të cilat formohen nën ndikimin e erërave në gjerësitë ekuatoriale quhen:

- A) Rryma të densitetit
- B) Rryma të rrjedhjes
- C) Rryma drifore
- D) Rryma të kompensimit

Pyetja 25.

Formohet në gjerësitë mesatare kryesisht nga masat ajrore arktike dhe nga ajri tropikal:

- A) Ajri arktik
- B) Ajri tropikal
- C) Ajri polar
- D) Ajri ekuatorial

Pyetja 26.

Zhvendosja ose lëvizja e cikloneve në vija të përgjithshme ruan drejtimin:

- A) Lindje-Perëndim
- B) Perëndim-Lindje
- C) Veri-Perëndim
- D) Veri-Lindje

Pyetja 27.

Gjatë ardhjes së cikloneve në vendin tonë, moti karakterizohet nga:

- A) Shtim të vranësirës dhe reshjeve
- B) Kthjellim të motit e pakësim të reshjeve
- C) Shtim të vranësirës dhe ulje të temperaturës
- D) Kthjellim të motit dhe rritje të temperaturës

Pyetja 28.

Qarkullimi i madh i ujit në natyrë është sipas drejtimit:

- A) Det-atmosferë-det
- B) Det-atmosferë-tokë
- C) Det-Atmosferë-tokë-det
- D) Det-atmosferë-det-tokë

Pyetja 29.

Kripësia më e madhe e oqeanëve për shkak të avullimit më të madh është në:

- A) Zonat Polare
- B) Zonat Mesatare
- C) Zonat Ekuatoriale
- D) Zonat Tropikale

Pyetja 30.

Përmbajtja e gazeve në ujin e detit varet nga:

- A) Temperatura dhe kripësia
- B) Thellësia dhe temperatura
- C) Thellësia dhe kripësia
- D) Avullimi dhe rreshjet

Pyetja 31.

Shkak për formimin e baticave e zbaticave është:

- A) Forca tërheqëse e Hënës dhe e Diellit
- B) Ndryshimi i temperaturës së ujit të detit
- C) Ndryshimi i thellësisë së detit
- D) Gjerësia gjeografike ku ndodhet deti

Pyetja 32.

Toka, planeti ynë merret si sferë me rreze mesatare:

- A) 6378 km
- B) 6371 km
- C) 5371 km
- D) 4371 km

Pyetja 33.

Bimësia dhe kafshët që popullojnë një hapësirë të përbashkët formojnë:

- A) Fitocenozen
- B) Florën
- C) Faunën
- D) Biocenozen

Pyetja 34.

Nuk është rrymë e ngrohtë oqeanike:

- A) Rryma e Australisë Lindore
- B) Rryma Kuroshivo
- C) Rryma e Perusë
- D) Rryma e Brazilit

Pyetja 35.

Nuk është faktor që ndikon në formimin e borës së përhershme:

- A) Temperatura e ulët
- B) Lagështira e madhe e ajrit
- C) Pjerrësia e relievit
- D) Presioni i shtresave të borës

Pyetja 36.

Kushti kryesor për lindjen e rrëshqitjeve është:

- A) Lartësia e relievit
- B) Prania e argjilave
- C) Peshja e materialit
- D) Pjerrësia e relievit

Pyetja 37.

Shkaku kryesor që shtresat shkëmbore pësojnë shformime rrudhosëse apo shkëputëse janë:

- A) Lëvizjet epirogjenike
- B) Lëvizjet orogjenike
- C) Dukuritë vullkanike
- D) Dukuritë sizmike

Pyetja 38.

Viti ka vetëm një stinë në:

- A) Brezin e nxehtë
- B) Brezin mesatar verior
- C) Brezin mesatar jugor
- D) Brezin e ftohtë polar

Pyetja 39.

Pasojë e rrotullimit të Tokës rreth boshtit të vet është:

- A) Shtypja e Tokës në pole
- B) Formimi i stinëve
- C) Ndryshimi i energjisë diellore
- D) Ndryshimi i ndriçimit të Tokës

Pyetja 40.

Gjerësi gjeografike quhet:

- A) Largësia e një vendi të dhënë e shprehur në metra nga ekuatori në drejtim të poleve.
- B) Largësia e një vendi të dhënë e shprehur në gradë nga polet drejt ekuatorit.
- C) Largësia e një vendi të dhënë e shprehur në metra nga polet drejt ekuatorit.
- D) Largësia e një vendi të dhënë e shprehur në gradë nga ekuatori në drejtim të poleve.

Pyetja 41.

Nuk është veçori e litosferës:

- A) Është shtresë plastike.
- B) Është e ndarë në blloqe të ngurta.
- C) Ka trashësi deri 100 km.
- D) Është e përbërë nga shkëmbinj.

Pyetja 42.

Përmasat më të mëdha i kanë:

- A) Liqenet tektonike
- B) Liqenet karstike

- C) Liqenet akullnajore
- D) Liqenet lagunore

Pyetja 43.

Planeti ynë ndahet në disa breza ndriçimi për shkak të:

- A) Ndryshimit të temperaturës në gjerësi të ndryshme gjeografike.
- B) Ndryshimit të ndricimit në gjerësi të ndryshme gjeografike.
- C) Ndryshimit të presionit atmosferik në gjerësi të ndryshme gjeografike.
- D) Ndryshimit të ndriçimit në gjatësi të ndryshme gjeografike.

Pyetja 44.

Largësisë prej 2 cm midis dy pikave A dhe B në hartën me shkallë 1: 5000 i korrespondon në terren:

- A) Largësia prej 1 km
- B) Largësia prej 2 km
- C) Largësia prej 5 km
- D) Largësia prej 10 km

Pyetja 45.

Sipërfaqja Moho shërben si kufi ndarës mes:

- A) Kores oqeanike dhe asaj bazaltike
- B) Kores tokësore dhe mantelit
- C) Mantelit dhe bërthamës së Tokës
- D) Litosferës dhe astenosferës

Pyetja 46.

Dukuria e albedos shpreh:

- A) Rrezatimin me valë të shkurtra që thithet nga toka e që rrezatohet në trajtën e rrezatimit me valë të gjata.
- B) Rrezatimin me valë të gjata që vjen nga sipërfaqja e tokës.

- C) Raportin mes rrezatimit që reflektohet dhe atij që vjen në një sipërfaqe të caktuar.
- D) Raportin mes rrezatimit që vjen dhe atij që reflektohet.

Pyetja 47.

Karakteri zbritës i masave ajrore është shkak për presionin e lartë atmosferik në:

- A) Gjerësitë ekuatoriale
- B) Gjerësitë tropikale
- C) Gjerësitë mesatare
- D) Gjerësitë polare

Pyetja 48.

Ndryshimi adiabatik i temperaturës së ajrit është:

- A) Ndryshimi i temperaturës në gjerësi të ndryshme
- B) Ndryshimi i temperaturës kur ajri ngjitet
- C) Ndryshimi i temperaturës kur ajri zbret
- D) Ndryshimi i temperaturës pa shkëmbyer nxehtësi me rrethinat

Pyetja 49.

Është pasojë e lëvizjes ngritëse të sipërfaqes së Tokës:

- A) Rritja e sipërfaqes së deteve
- B) Kthimi i gadishujve në ishuj
- C) Klima bëhet më detare
- D) Rritja e sipërfaqes së kontinenteve

Pyetja 50.

Dukuria e valëzimit të përzierë formohet:

- A) Kur vala e detyruar ndryshon drejtimin
- B) Kur vala e lirë ndodhet në të njëjtën kohë me valën e detyruar
- C) Kur vala e lirë ndryshon shpejtësinë
- D) Kur vala e detyruar ndryshon shpejtësinë

Pyetja 51.

Sipas klasifikimit klimatik të Institutit Hidrometeorologjik, në vendin tonë dallohen:

- A) 2 zona klimatike
- B) 4 zona klimatike
- C) 6 zona klimatike
- D) 8 zona klimatike

Pyetja 52.

Është erë e fothhtë:

- A) Shiroku
- B) Murlani
- C) Puhia
- D) Cikloni

Pyetja 53.

Peisazhet eolike krijohen nga veprimtaria e:

- A) Akullnajave
- B) Lumenjve
- C) Deteve
- D) Erës

Pyetja 54.

Përqindjen më të madhe në atmosferë e zë:

- A) Azoti
- B) Hidrogjeni
- C) Heliumi
- D) Oksigjeni

Pyetja 55.

Nuk bën pjesë në produktet e ngurta të vullkaneve:

- A) Lapilet

- B) Metani
- C) Rëra vullkanike
- D) Hiri vullkanik

Pyetja 56.

Nuk është objekt i studimit të Gjeografisë Fizike:

- A) Klima
- B) Tokat
- C) Relievi
- D) Popullsia

Pyetja 57.

Në litosferë gjenden:

- A) 4 pllaka të mëdha
- B) 5 pllaka të mëdha
- C) 6 pllaka të mëdha
- D) 7 pllaka të mëdha

Pyetja 58.

Nuk bën pjesë në klasifikimin e hartave sipas përmbajtjes:

- A) Harta turistike
- B) Harta tematike
- C) Harta topografike
- D) Harta gjeologjike

Pyetja 59.

Lëvizja e baticave dhe zbaticave përsëritet rregullisht brenda këtij afati kohor:

- A) 1 muaji
- B) 1 jave
- C) 1 ditë-nate
- D) 1 ore

Pyetja 60.

Nuk është tipar i lumenjve të vendit tonë:

- A) Pjerrësia e shtratit
- B) Gjatësia e vogël
- C) Dendësia e madhe
- D) Lundrueshmëria

Pyetja 61.V) 2

Lignosa përfshin:

- A) Bashkësinë bimore barishtore
- B) Bashkësinë bimore drunore
- C) Bashkësinë bimore drunore dhe shkurre
- D) Bashkësinë bimore shkretinore

Pyetja 62.V) 2

Në anticiklon ajri bën këtë lëvizje:

- A) Nga periferia drejt qendrës me drejtim ngjitës
- B) Nga periferia drejt qendrës me drejtim zbritës
- C) Nga qendra drejt periferisë me drejtim ngjitës
- D) Nga qendra drejt periferisë me drejtim zbritës

Pyetja 63.

Tërmetet nuk shkaktohen nga:

- A) Rrëshqitjet e tokës
- B) Zhvendosjet e masave shkëmbore
- C) Vullkanet
- D) Shembjet e boshllëqeve nëntokësore

Pyetja 64.

Ndryshimi mes mjegullave dhe reve lidhet me:

- A) Formën e tyre
- B) Madhësinë e tyre
- C) Përbërjen e tyre
- D) Lartësinë ku bëhet kondensimi i avujve të ujit

Pyetja 65.

Sfera e veprimtarisë së njeriut në planetin tonë shtrihet në:

- A) Kufirin e sipërm të kores tokësore deri në kufirin e sipërm të troposferës
- B) Kufirin e poshtëm të kores tokësore deri në kufirin e sipërm të troposferës
- C) Kufirin e poshtëm të kores tokësore deri në kufirin e poshtëm të troposferës
- D) Kufirin e sipërm të kores tokësore deri në kufirin e sipërm të atmosferës

Pyetja 66.

Në ndërtimin e brendhëm të Tokës, shtresa granitike bën pjesë në:

- A) Litosferë
- B) Mantel
- C) Bërthamë
- D) Kore tokësore

Pyetja 67.

Kanë karakter eruptiv vullkanet e tipit:

- A) Havajan
- B) Vezuvian
- C) Kalder
- D) Tsunami

Pyetja 68.

Pikat e ujit në retë e shiut bien poshtë kur:

- A) Forca e gravitetit është më e madhe se forcat që i mbajnë këto pika në atmosferë.
- B) Forca e gravitetit është më e vogël se forcat që i mbajnë këto pika në atmosferë.
- C) Forca e gravitetit është e njëjtë me forcat që i mbajnë këto pika në atmosferë.
- D) Masa e këtyre pikave bëhet aq e madhe sa të mos qëndrojnë më në atmosferë.

Pyetja 69.

Faktori kryesor që ndikon në jetën dhe zhvillimin e brigjeve detare është:

- A) Era
- B) Temperatura e ajrit
- C) Valët detare
- D) Rrymat oqeanike

Pyetja 70.

Gejzerët janë:

- A) Lloj i veçantë i ujërave arteziane
- B) Lloj i veçantë i ujërave karstike
- C) Lloj i veçantë i ujërave freatike
- D) Lloj i veçantë i burimeve termale

Pyetja 71.

Sipërfaqja e Gutenbergut shërben si kufi ndarës midis:

- A) Kores tokësore e Mantelit
- B) Kores tokësore e Litosferës
- C) Mantelit e Bërthamës së Tokës
- D) Bërthamës së brendshme e asaj të jashtme

Pyetja 72.

Nuk është dukuri që ndodh kur pllakat në litosferë përplasen mes tyre:

- A) Fundosjet tektonike
- B) Shkëputjet tektonike
- C) Tërmetet
- D) Vullkanet

Pyetja 73.

Elementi ndryshues mes masave ajrore në një front atmosferik është:

- A) Madhësia e masave ajrore
- B) Vetitë fizike të masave ajrore
- C) Drejtimi i lëvizjes së masave ajrore
- D) Shpejtësia e lëvizjes së masave ajrore

Pyetja 74.

Nuk janë rryma oqeanike:

- A) Rrymat rrjedhëse tropikale
- B) Rrymat drifore
- C) Rrymat e densitetit
- D) Rrymat e kompensimit

Pyetja 75.

Dukuria e stratifikimit homotermik ne liqen ndodh kur:

- A) Uji është më i ngrohtë në sipërfaqe se në thellësi.
- B) Uji është më i ftohtë në sipërfaqe se në thellësi.
- C) Uji ka të njëjtën temperaturë në gjithë thellësinë e liqenit.
- D) Uji ka të njëjtën tejdrukshmëri në gjithë thellësinë e liqenit.

KIMI E PËRGJITHSHME

Pyetja 1.

Lëndë quhet çdo gjë:

- A) Që ka masë dhe shndërrohet.
- B) Që zë hapësirë dhe shndërrohet.
- C) Zë hapësirë dhe ka masë.
- D) Ka masë dhe shndërrohet.

Pyetja 2.

Cila nga substancat e mëposhtme nuk është e përbërë:

- A) K
- B) H₂O
- C) NaCl
- D) KF

Pyetja 3.

Vlera e numrit të Avogadros është:

- I) $5.02 \cdot 10^{23}$
- J) $6.02 \cdot 10^{23}$
- K) $7.02 \cdot 10^{23}$
- L) $8.02 \cdot 10^{23}$

Pyetja 4.

Gjeni përgjigjen e gabuar. *Kimia organike është:*

- I) Kimia e komponimeve të karbonit.
- J) Kimia që studion proteinat.
- K) Kimia që studion lyrat.
- L) Kimia që studion elementët.

Pyetja 5.

Mostra e përbërë nga oriz dhe grurë është:

- I) Përbërje kimike

- J) Përzierje kimike
- K) Përzierje homogjene
- L) Përzierje heterogjene

Pyetja 6.

Ndarja e përzierjes së sheqerit me rërën bëhet me metoda:

- I) Kimike
- J) Biofizike
- K) Fizike
- L) Të treja bashkë

Pyetja 7.

Në një aliazh që peshon 3kg ka 1kg Cu dhe në një aliazh tjerër që peshon 10kg ka 3kg Cu. Në cilin aliazh përqindja e Cu është më e lartë dhe sa?

- A) Aliazhi i parë 30% Cu
- B) Aliazhi i parë 33% Cu
- C) Aliazhi i dytë 30% Cu
- D) Aliazhi i dytë 33% Cu

Pyetja 8.

Formula ku përdoret raporti më i thjeshtë numerik quhet:

- I) Formulë molekulare
- J) Formulë empirike
- K) Formulë strukturore
- L) Formulë e vërtetë

Pyetja 9.

Paraqitja e reaksioneve me anë të simboleve dhe formulave të substancave që marrin pjesë quhet:

- I) Përzirje kimike
- J) Komponentet kimike
- K) Produkt nisëtor
- L) Barazim kimik

Pyetja 10.

Sasia maksimale e substancës së tretur në një sasi të dhënë tretësi për një temperaturë të caktuar quhet:

- I) Tretshmëri
- J) Përqëndrim
- K) Tretësirë
- L) Tretësirë e ngopur

Pyetja 11.

3 mole Na përmbajnë:

- I) $6.02 \cdot 10^{23}$ grimca
- J) $12.04 \cdot 10^{23}$ grimca
- K) $18.06 \cdot 10^{23}$ grimca
- L) $24.08 \cdot 10^{23}$ grimca

Pyetja 12.

Nëse $A_{rNa} = 23$ dhe $A_{rCl} = 35.5$, masa molare e NaCl është:

- I) 28.5
- J) 30.5
- K) 48.5
- L) 49.5

Pyetja 13.

Uji është tretës i mirë për:

- I) NaCl
- J) Parafinën
- K) Qymyrin
- L) Letrën

Pyetja 14.

Cili prej reaksioneve të mëposhtme është edhe reaksion asnjësimi edhe reaksion këmbimi?

- I) $H_2 + O_2 \rightarrow H_2O$
- J) $CH_4 + O_2 \rightarrow CO_2 + H_2O$
- K) $NaOH + HCl \rightarrow NaCl + H_2O$
- L) $H_2 + Cl_2 \rightarrow HCl$

Pyetja 15.

Numri moleve të substancës së tretur në një litër tretësirë:

- I) Normalitet
- J) Molaritet
- K) Asnjësim
- L) Hidrolizë

Pyetja 16.

Ndarja e një substance jofluore në përbërësit e saj quhet:

- I) Avullim
- J) Ngrirje
- K) Distilim
- L) Kondesim

Pyetja 17.

Procesi në të cilën numri i oksidimit pëson ulje algjebrike quhet:

- I) Reduktim
- J) Oksidim
- K) Fermentim
- L) Hidrolizë

Pyetja 18 .

Tretësira 15 % BaCl_2 përmban:

- I) 10g. BaCl_2 85g. H_2O
- J) 15g. BaCl_2 85g H_2O
- K) 10g. BaCl_2 95g. H_2O
- L) 15g. BaCl_2 95g H_2O

Pyetja 19 .

Cili prej reaksioneve të mëposhtme është reaksion këmbimi:

- I) $\text{A} + \text{B} = \text{C}$
- J) $\text{AB} + \text{CD} = \text{AD} + \text{CB}$
- K) $\text{AB} = \text{A} + \text{B}$
- L) $\text{A} + \text{B} + \text{C} = \text{ABC}$

Pyetja 20.

Masa molare e C=12.Sa mole ka në 24g C?

- I) 1 Mol
- J) 2 Mol
- K) 3 Mol
- L) 4 Mol

Pyetja 21.

Procesi i depozitimit varet nga:

- I) Kushtet e motit
- J) Struktura e sipërfaqes
- K) Përmbajtja e ndotësve
- L) Të treja bashkë

Pyetja 22.

Sipas Arrheniusit acidi është substanca që shpërbashkohet në ujë duke dhënë:

- E) Jone H_3O^+
- F) Jone OH^-
- G) Jone F^-
- H) Jone Cl^-

Pyetja 23.

Cila nga substancat e mëposhtme është kripë:

- E) H_2O
- F) HBr
- G) H_2O_2
- H) KCl

Pyetja 24.

Reaksioni midis një acidi dhe një baze quhet:

- E) Titullim
- F) Oksidim
- G) Asnjësim
- H) Reduktim

Pyetja 25 .

Rritja temperaturës gjatë procesit të ndotjes shkakton:

- E) Rritjen e sasisë së O_2
- F) Uljen e sasisë së O_2
- E) Rritjen e sasisë së Cl_2
- F) Uljen e sasisë së Cl_2

Pyetja 26

Lëndët pluskuese si shkumrat dhe vajrat ndikojnë në:

- E) Rritjen e fotosintezës
- F) Zvogëlimin e fotosintezës
- G) Rritjen e bimësisë
- H) Rritjen e fitoplanktonit

Pyetja 27

Ujërat eutrofikë karakterizohen nga:

- E) Ujë i kulluar dhe lulëzim i bimëve
- F) Ujë i kulluar dhe lulëzim i algave

- G) Ujë i ndotur dhe lulëzim i bimëve
- H) Ujë i ndotur dhe lulëzim i algave

Pyetja 28.

Numri i oksidimit të H është +1. Në cilin rast n.o është -1:

- E) H_2O .
- F) NaOH
- G) NaH
- H) HNO_3

Pyetja 29.

Përzierja gazeve që përbëjnë atmosferën e tokës quhet:

- E) Shtresë ozoni
- F) Stratosferë
- G) Litosferë
- H) Ajër

Pyetja 30.

Prania e substancave në atmosferë të krijuara nga aktiviteti njerëzor ose proceset natyrore quhet:

- E) Larmishmëri
- F) Ndotje
- G) Biodiversitet
- H) Shkarkim

Pyetja 31.

Tri stadet e ndotjes sipas rradhës janë:

- E) Transmetim, shkarkim, depozitim.
- F) Depozitim, shkarkim, transmetim.
- G) Shkarkim, transmetim, depozitim.
- H) Depozitim, transmetim, shkarkim.

Pyetja 32.

Numri i oksidimit të N në HNO_3 është:

- E) +2
- F) +3
- G) +4
- H) +5

Pyetja 33.

Në gjysmë reaksionin e mëposhtëm kemi të bëjmë me: $Na^0 - 1e \rightarrow Na^{+1}$

- E) Reduktim
- F) Oksidim
- G) Asnjësim
- H) Hidrolizë

Pyetja 34.

Cili prej komponimeve nuk është bazë?

- E) FeOH
- F) KOH
- G) LiF
- H) NaOH

Pyetja 35.

Cila prej reaksioneve të mëposhtme nuk është reaksion oksido-reduktimi?

- E) $H_2 + O_2 \rightarrow H_2O$
- F) $H_2 + Cl_2 \rightarrow HCl$
- G) $HCl + NaOH \rightarrow NaCl + H_2O$
- H) $Fe_2O_3 + Al \rightarrow Al_2O_3 + Fe$

Pyetja 36.

Përmbajtja e lëndëve të pezullta, NBO, treguesit kimikë dhe e mikroorganizmave që shkaktojnë sëmundje janë:

- E) Përbërësit e ndotjes
- F) Themeluesit ndotjes
- G) Kërkuesit ndotjes
- H) Treguesit e ndotjes

Pyetja 37.

Ujërat që në kushte natyrore kanë një përmbajtje relativisht të ulët të N dhe P quhen :

- E) Oligotrofikë
- F) Autotrofikë
- G) Eutrofikë
- H) Politrofikë

Pyetja 38.

Metodat kryesore të pastrimit të ujit janë:

- E) Mekanike, fizike, kimike, zhgazim, dezinfektim

- F) Hidrolizim, fizike, kimike, zhgazim, dezinfektim
- G) Reduktim, fizike, kimike, zhgazim, dezinfektim
- H) Asnjësim, fizike, kimike, zhgazim, dezinfektim

Pyetja 39.

Cila prej molekulave të mëposhtëme është acid?

- A) BF_3
- B) CO_2
- C) HF
- D) SF_6

Pyetja 40

Dekantimi është një proces që realizon një pastrim:

- A) Kimik
- B) Mekanik
- C) Fizik
- D) Neutral

Pyetja 41 .

Në cilin rast numri i oksidimit të azotit është +3:

- A) NO
- B) N_2O_3
- C) N_2O
- D) N_2

Pyetja 42.

Cila nga substancat e mëposhtme nuk është bazë:

- A) NH_4OH
- B) $\text{Fe}(\text{OH})_3$
- C) $\text{Ca}(\text{OH})_2$
- D) $\text{Cu}(\text{OH})_2\text{CO}_3$

Pyetja 43.

Substancat që treten të paktën në sasi 10 gram në 1 litër tretës quhen:

- A) Pak të tretshme
- B) Të patretshme
- C) Të tretshme
- D) Elekrolitë

Pyetja 44.

Sistemi SI mbështetet në:

- A) 4 njësi themelore dhe 2 shtesë
- B) 5 njësi themelore dhe 2 shtesë
- C) 7 njësi themelore dhe 2 shtesë
- D) 8 njësi themelore dhe 2 shtesë

Pyetja 45.

Cili nga reaksionet e mëposhtme është një asnjësim:

- A) Acid + Bazë
- B) Acid + Acid
- C) Acid + Kripë
- D) Bazë + Bazë

Pyetja 46.

Cila prej formulave të mëposhtme është formula empirike e C_2H_2 ?

- A) C_2H_2
- B) CH_2
- C) CH
- D) C_2H

Pyetja 47.

Cila nga alternativat e mëposhtme përbëhet nga një element:

- A) Diamanti
- B) Gjaku
- C) Ajri
- D) Kripa egjellës

Pyetja 48.

Tretësira që përmban 48.5g NaCl në 1 litër ujë quhet:

- A) molare
- B) molare
- C) 1 molare
- D) 2 molare

Pyetja 49.

Tretësirat janë:

- A) Substanca të thjeshta
- B) Substanca të përbëra
- C) Elemente kimike

D) Përzierje kimike

Pyetja 50.

Barazimi i mëposhtëm $2\text{H}_2 + \text{O}_2 = 2\text{H}_2\text{O}$ tregon:

- A) Substancat nisëto
- B) Produktet e reaksionit
- C) Numrin e moleve që hyjnë në reaksion
- D) Të treja së bashku

Pyetja 51.

Sipas Lavuazje, kur një substancë nuk zërthehet në substanca të thjeshta quhet:

- M) Elementë
- N) Përzierje
- O) Përbërje
- P) Simbol

Pyetja 52.

Simboli i azotit është:

- I) K
- J) H
- K) N
- L) F

Pyetja 53.

Substancat e përbëra nga dy ose më shumë elementë quhen:

- M) Të thjeshta
- N) Të përbëra
- O) Përzierje
- P) Fazë

Pyetja 54.

Cila nga alternativat e mëposhtme është molekula e ujit:

- M) H_2O_2
- N) NaCl
- O) HF
- P) H_2O

Pyetja 55.

Njësia matëse në SI e temperaturës është:

- M) Celcius

- N) Kelvin
- O) Faradei
- P) Kandel

Pyetja 56.

Cila është përgjigja e saktë? *Shuma e masave atomike të atomeve që përbëjnë një molekulë quhet:*

- M) Masë atomike
- N) Masë molekulare
- O) Masë elementare
- P) Masë normale

Pyetja 57.

Cila është përgjigja e saktë? *Substancat nisëtore shkruhen:*

- E) Në të majtë të reaksionit
- F) Në të djathtë të reaksionit
- G) Në të dyja anët e reaksionit
- H) Mbi shigjetën e reaksionit

Pyetja 58.

Molariteti bazohet në numrin e moleve të substancës së tretur në:

- M) 1 litër tretësirë
- N) 1 litër tretës
- O) 2 litër tretësirë
- P) 2 litër tretës

Pyetja 59.

Nuk është kripë:

- M) NaCl
- N) HBr
- O) Na₂CO₃
- P) KF

Pyetja 60.

Reduktimi ndryshon nga oksidimi pasi në rastin e parë numri i oksidimit:

- M) Pëson rritje algjebrike
- N) Pëson ulje algjebrike
- O) Nuk ndryshon
- P) Merr vlerë negative

Pyetja 61.

Numri i oksidimit i O₂ te H₂O është:

- M) -2
- N) -1
- O) 1
- P) 2

Pyetja 62.

Cila nga formulat e mëposhtme është formulë acidi:

- M) H₂O
- N) KCl
- O) NaOH
- P) HCl

Pyetja 63.

Cila nga formulat e mëposhtme është formulë baze:

- M) CaCl₂
- N) HNO₃
- O) KOH
- P) HBr

Pyetja 64.

Li⁺, Na⁺, K⁺ quhen:

- M) Anjone
- N) Katjone
- O) Elektrolitë
- P) Kripëra

Pyetja 65.

Substancat që shpërbashkohen pjesërisht në tretësirë ujore quhen:

- M) Elektrolitë të dobët
- N) Elektrolitë të fortë
- O) Elektrolitë mesatarë
- P) Elementë galvanikë

Pyetja 66.

Nëse Ar_K=39, Ar_O=16 dhe Ar_H=1, masa molare e KOH është:

- M) 44
- N) 46
- O) 54

P) 56

Pyetja 67.

Është 3 molare substanca që përmban:

M) $6.06 \cdot 10^{23}$

N) $9.06 \cdot 10^{23}$

O) $18.06 \cdot 10^{23}$

P) $24.06 \cdot 10^{23}$

Pyetja 68.

Formula empirike e substancave të thjeshta përbëhet vetëm nga:

M) Simboli

N) Anjoni

O) Katjoni

P) Elektroliti

Pyetja 69.

Formula empirike e Na_2O_2 është:

M) Na_2O

N) NaO

O) Na_2O_2

P) NaO_2

Pyetja 70.

Shtimi i përbërjeve të pasura me N dhe P krijon liqene:

M) Oligotrofik

N) Mezotrofik

O) Trofik

P) Eutrofik

Pyetja 71.

Përzierja e ujit me kripën është:

M) Tretësirë kimike

N) Komponim kimik

O) Përbërje kimike

P) Elementë kimik

Pyetja 72.

Temperatura e ajrit me rritjen e lartësisë mbi nivelin e detit:

I) Ulet

- J) Rritet
- K) Nuk ndryshon
- L) Luhatet

Pyetja 73.

Masa molare e formulës empirike të H_2O_2 është:

- I) 17
- J) 18
- K) 19
- L) 20

Pyetja 74.

Filtrimi është një metodë:

- I) Kimike
- J) Fizike
- K) Neutrale
- L) Termike

Pyetja 75.

Gjeni përgjigjen e saktë. *Materialet homogjene përbëhen nga:*

- G) 1 fazë
- H) 2 faza
- G) 3 faza
- H) 3 faza